



PLANI I BIZNESIT 2010

PLANI I BIZNESIT

2010

Durres Port Authority
Adresa. Lagja Nr. 1
Rruga Tregtare – Durres
Albania

Drejtor i Pergjithshem
Ing. Eduard Ndreu
Tel/Fax: +355 52 223115
Tel: +355 52 223384
e.ndreu@apdurres.com.al
www.apdurres.com.al

Permbajtja	Faqja
1. HYRJE	2
2. TREGUESIT E VOLUMIT TË PËRPUNIMIT TË MALLRAVE PËR VITIN 2010	3
2.1 Treguesit e volumit të punës së ngarkim-shkarkimit të mallrave në total	3
2.2 Importi I mallrave	3
2.3 Eksporti I Mallrave	3
2.4 Tarifa mesatare e perpunimit te mallrave	4
3. TREGUESIT E NGARKIM SHKARKIMIT TË KONTENIERËVE	4
4. TREGUESIT E SHËRBIMIT TË TRAGETEVE	5
5. PROGRAMI I TREGUESVE TË PUNËS	6
6. TREGUESIT E INVESTIMEVE TË BRENDSHME PËR VITIN 2010	7
7. PARASHIKIMI I INVESTIMEVE 2010	8
7.1 PARASHIKIMI I INVESTIMEVE PËR “NDËRTIM MONTIME”	8
7.2 PARASHIKIMI INVESTIMEVE PER MAKINERI DHE PAJISIE	12
7.3 Parashikimi i investimeve për blerje “Automekanizma”	15
7.4 Parashikimi i investimeve për Blerje “AUTOMJETE”	17
7.5 Blerje Pajisje, Sisteme Informatike Dhe Orendi Per Zyra	18
7.6 Parashikimi i investimeve për „Konsulenca, Studime dhe Projekte“	20
7.7 Parashikimi i investimeve për zërin “Të tjera investime”	24
8. PLANIFIKIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2010.	25
8.1 Të ardhurat nga ngarkim shkarkimi i mallrave gjenerale	25
9. TREGUESIT E SHPENZIMEVE	31
9.1 Treguesit shpenzimet Pagat + Shpërblimi	31
9.2 Treguesit e amortizimit	32
9.3 Parashikimi i Shpenzimeve nga blerja e materialeve dhe sherbimeve	34
9.4 Shpenzime te ndryshme	37
10. FITIMI DHE SHPËRNDARJE E TIJ	40

1. HYRJE

Në zbatim të ligjit 9130 dt. 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual", 24 pika 2 neni 27, të VKM Nr.596 dt.10.09.2004 "Për miratimin e Statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe riorganizimin e tij", neni 9 dhe neni 10 pika d, Autoriteti Portual Durrës hartoi Projekt Planin e Biznesit të Vitit 2010 me relacionet dhe pasqyrat ekonomiko financiare bashkangjitur.

Në hartimin e këtij Projekt Plani Biznesi APD-ja është mbështetur edhe në planin e biznesit për vitet 2005-2010 të hartuara nga shoqëria "Deloitte & Touche"

Në hartimin e këtij programi ekonomik, jemi bazuar në realizimin e treguesve ekonomiko financiarë të vitit 2009, në dinamikën e realizimit të këtyre treguesve nga një vit në tjetrin, në përvojën e personelit tonë menaxhues, në të dhënat që kemi marrë nga agjensi të ndryshme që operojnë në port, si dhe në kërkesat dhe treguesit ekonomikë dhe financiarë që kanë paraqitur Terminalet dhe Drejtoritë e ndryshme të APD-së.

Disa nga treguesit kryesorë ekonomiko financiarë, të parashikuar në Projekt Programin Ekonomiko Financiar të vitit 2010, krahasuar këto dhe me planin e biznesit dhe realizimin e pritshëm të vitit 2009 janë si me poshte:

Në 1000 lekë

1.	Emërtimi i treguesave	Programi i vitit 2009	I pritshmi i vitit 2009	Programi i vitit 2010
1	Të ardhurat	2,668,896	2,852,603	3,079,935
2	Shpenzimet	2,176,510	2,259,936	2,521,970
3	Fitimi bruto	492,386	592.667	557.966
4	Tatimi mbi fitimin	49,239	59,267	77,797
5	Fitimi neto	404,557	941,979	480.169
Shpërndarja e fitimit :				
6	Rezervë ligjore 5 %	22,157	26,670	24,008
7	Rezerva për zhvill. 80 %	354,518	426,720	384,135
8	Dividenti 15 %	66,472	80,010	72,025
9	Numri i punonjësve	697	623	581
10	Fondi i pagave gjithsej	525,612	459,702	510,936
11	Paga mesatare mujore	62,842	62,751	73
12	Paga mesatare vjetore	754,284	737,884	879
13	Investimet gjithsej	2,275,072	1,055,900	1,757,048

Treguesit e ekonomiko financiarë, te parashikuar per vitin 2010, po i trajtojmë në mënyrë të detajuar si më poshtë:

2. TREGUESIT E VOLUMIT TË PËRPUNIMIT TË MALLRAVE PËR VITIN 2010

Volumi i perpunimit te mallrave që parashikohet të përpunohet gjatë vitit 2010, është hartuar duke shfrytëzuar te gjitha burimet e mundeshme te informacionit, me qëllim qe ky parashikim te jete sa me i sakte. Per kete qëllim , ne iu drejtuam zyrtarisht të gjitha agjensive Spedicionere të cilat operojnë në Port, që të dërgonin një informacion mbi të dhënat, për realizimin e pritshëm 2009 dhe për volumin e tonit fizik, që ato parashikojnë të përpunojnë për vitin 2010..

2.1 Treguesit e volumit të punës së ngarkim-shkarkimit të mallrave në total

Në programin e vitit 2010 janë parashikuar te perpunohen 3.418 mijë ton, nga 3.122 mijë ton qe jane realizuar ne vitin 2009, duke parashikuar 296 mijë ton me shume ose 9.4 % me shume nga viti 2009.

2.2 Importi I mallrave

Per vitin 2010 volumi i punës së ngarkim-shkakimit për mallrat e importit është parashikuar në masën 2.462 mijë ton, ndersa realizimi i vitit 2009 ka qene 2.476 mijë ton, pa parashikuar rritje per vitin 2010.

Për vitin 2010 mallrat e importuara me anije janë parashikuar në masën 2.007 mijë ton, ndërsa realizimi i vitit 2009 ka qene 2.032 mijë, pa parashikuar nje rritje per kete vit, duke qendruar ne volumet e vitit 2009

Per mallrat qe do te importohen me konteinere parashikohen 553 mijë ton kundrejt 504 mijë ton te realizuar per 2009, 49 mijë ton me shume ose 10%

Mallrat e hyra me tragete për vitin 2010 janë parashikuar në masën 455 mijë ton, duke parashikuar nje rritje prej 11 mijë ton.

Nje informacion te detajuar japin pasqyrat 1/2 permbledhese per te gjithë grup mallrat e ngarkim-shkarkimit

2.3 Eksporti I Mallrave

Duke ju referuar faktit te vitit 2009, është parashikuar nje rritje e volumit te mallrave qe do te eksportohen. Per vitin 2010 janë parashikuar 956 mijë ton kundrejt 645 qe u realizuan per vitin 2009, pra 311 mijë ton me shume ose 48%. Kjo rritje parashikohet si rritje e volumit te eksportit te cimentos rifuxho dhe te mineralit te kromit. Ne vitin 2010, eksporti per mineralin e kromit parashikohet te jete me nje rritje prej 62 mijë ton me shume se 2009 ose 80% dhe per cimenton rifuxho parashikohet te jete me nje rritje ne vlere prej 148 mijë me shume se viti 2009.

Mallrat qe do te exportohen me konteniere, per vitin 2010 jane parashikuar ne masen 368 mije ton , nga 294 mije ton qe u realizuan ne vitin 2009 ose nje rritje prej 74 mije ton ,ose 25% me shume.

Mallrat e dala me Tragete në programin e vitit 2010 janë prarashikuar në masën 235 mijë ton, nga 229 mije ton qe jane realizuar ne vitin 2009 ose 6 mije tone me shume, ose 3%. Kjo rritje është si pasojë e rritjes së produktit të brëndshëm bruto, sidomos ne industrine e konfeksioneve.

Nje informacion te detajuar japin pasqyrat 1/2 permbledhese per te gjithë grup mallrat e ngarkim-shkarkimit.

2.4 Tarifa mesatare e perpunimit te mallrave

Implementimi i struktures se re tarifore per vitin 2009, sjell dhe ndryshimin e tarifës mesatare të përpunimit te mallrave.

Per vitin 2010 është parashikuar per tu perpunuar një volum më i madh mallrash.Per përpunimin e mallrave, per vitin 2010 parashikohet nje tarife prej 661 leke per 1 ton mall te perpunuar, nga 628 leke qe u realizua tarifa per vitin 2009, ose nje rritje tarifës mesatare, në krahasim me nje vit më parë, prej 33 leke ose ne masen 5.25 %. Tarifa e përpunimit të mallrave, per vitin 2010, paraqitet sipas tabelës së mëposhtëme:

2	Pa TVSH	E ardhura 000/lek	Toni 000/ton	Tarifa mesatare
1	Fakti '09	1.036.948	1,651	628
2	Programi '10	1.194.158	1.807	661
Nr.	Me TVSH	E ardhura	Toni	Tarifa
1	Fakti '09	1.192.041	1.651	722
2	Programi '10	1.359.873	1,807	753

3. TREGUESIT E NGARKIM SHKARKIMIT TË KONTENIERËVE

Përpunimi i kontenierëve vitet e fundit në Portin e Durrësit, ka patur ritme të larta zhvillimi, nga një vit në tjetrin. Kështu në vitin 2004 janë përpunuar 8.292 TEU kontenierë, në vitin 2005 janë përpunuar 15.286 TEU kontenierë, në vitin 2006 janë përpunuar 21.500 TEU kontenierë, ndërsa për vitin 2007 janë përpunuar 33.127 TEU kontenierë, për vitin 2008 jane perpunuar **46798** TEU konteniere, dhe per vitin 2009 jane perpunuar **68622** TEU. Ne vitin 2010 parashikohen te perpunohen **85.875** TEU konteniere, nga **68.622** TEU

konteniere qe janë realizuar në vitin 2009, parashikohet një rritje prej **17.253** TEU kontenierë, ose 25 % shumë.

Për vitin 2010 janë parashikuar të importohen 41.425 TEU kontenierë, nga 34.196 TEU kontenierë, që u realizuan në vitin 2009, me një rritje prej 7.229 TEU ose 21 % më shumë.

Eksporti për vitin 2009 është parashikuar për 44.453 TEU kontenierë, nga 34.426 TEU që u realizuan në vitin 2009, me një rritje prej 10.027 TEU kontenierë, ose 29 % më shumë.

4. TREGUESIT E SHËRBIMIT TË TRAGETEVE

Treguesit e shërbimit të trageteve për vitin 2010 janë parashikuar me një rritje duke patur parasysh levizjen dhe shtimin e numrit të trageve, në krahasim me realizimin e vitit 2009.

Realizimi 2009

4.	Pasagjere ne Total	876.026	Imbarkim	Disimbarkim
1	Rritur		366.081	377.507
2	Mitur		69.72	62.718
3	Mjete Total		119.36	152.147
4	Autovetura		86.642	114.446
5	Kamiona + Trajlera		32.718	37.701
6	Rejse Total		2.083	

Parashikimi per vitin 2010

4.	Pasagjere ne Total	805.162	Imbarkim	Disimbarkim
1	Rritur		402,689	415,258
2	Mitur		76.692	68,990
3	Mjete Total		131,296	167,362
4	Autovetura		95,306	125,891
5	Kamiona + Trajlera		35,990	41,471
6	Rejse Total		2.100	

Numri i pasagjerëve që parashikohen të qarkullojnë për vitin 2010 është 963,629 pasagjerë, nga 876.026 pasagjerë që është realizimi i vitit 2010, më shumë 87,603 pasagjerë ose 10% rritje.

Në hyrje janë parashikuar 484,248 pasagjerë, nga 440.225 pasagjerë që janë realizuar në vitin 2009, me një rritje prej 44,023 pasagjerë ose 10 % me shume.

Pasagjerët në dalje për vitin 2010 janë parashikuar 479,381, kundrejt 435.801 pasagjerë që janë realizuar ne vitin 2009, 43,580 pasagjerë më shumë ose 10%.

Per vitin 2010 parashikohen të qarkullojnë 298,658 mjete, nga 271.507 mjete qe kane qarkulluar ne vitin 2009, me një rritje prej 27,151 mjete ose 10 %.

Janë parashikuar të hyjnë 125,891 autovetura për vitin 2010, nga 114,446 që kanë hyrë në vitin 2009, ose parashikohet një rritje prej 11,445 autovetura.

Për vitin 2010 janë parashikuar që të hyjnë 41,471 kamiona dhe trajlera, nga 37,701 që kanë hyrë për vitin 2009, ose një rritje e lehtë prej 3,770 kamiona.

Autoveturat në dalje për vitin 2010 janë parashikuar 95,306 nga 86.642 autovetura që kanë dalë për vitin 2009, ose parashikohet një rritje prej 8,664 copë.

Kamiona dhe trajlera për vitin 2010 janë parashikuar të dalin gjithsej 35,990 copë nga 32.718 që kanë dalë në vitin 2009, ose parashikohet një rritje prej 3,272 copë.

Për vitin 2010 janë parashikuar që të përpunohen 2.100 rejse gjithsejt, nga 2.083 që janë përpunuar për vitin 2009, me një rritje prej 17 rejse.

5. PROGRAMI I TREGUESVE TË PUNËS

Fondi i pagave për vitin 2009 është parashikuar në vleren 510.936 mijë lekë, nga 459.582 mije leke qe eshte realizuar ne vitin 2009, me nje rritje prej 51.354 mije leke, ose 116.5%.

Numri i punonjësve për vitin 2010 është parashikuar 581 vetë nga të cilët 131 personel menaxhues dhe 450 personel operativ, nga 623 punonjes gjithsej qe ishin ne vitin 2009, .

Pasqyra e realizimit të fondit të pagës dhe numrit te punonjesve

5.	Emërtimi	Njësia Matjes	Programi 2009	Realizimi 2010	Diference program 2009 - realizim 2009	Programi 2010
1	Numri punonjës total	NR	697	623	72	581
2	Personel Operativ	NR	565	507	58	450
3	Personel menaxhues	NR	132	116	16	131

4	Fondi I Pagave vjetor	000/ L	525.612	459.702	65.91	510.936
5	Fondi Pagave mujor	000/ L	43.801	39.094	4.704	42.578
6	Paga baze vjetore	lekë	754.106	737.884	16.222	879.408
7	Paga Baze mujore	lekë	62.842	58.136	4.706	73.284

Numri i fuqise punetore per vitin 2010, eshte parashikuar per 581 punonjes, nga 623 punonjes qe kane qene ne vitin 2009, pra kemi nje ulje te numrit te fuqise punetore si pasoje e privatizimit te sektorit te mirembajtjes dhe te nje pjese te perpunimit te mallrave rifuzo nga operatori privat.

Nje nga arsyet e rritjes se pages mesatare mujore dhe te fondit te pagave ne pergjithesi ne raport me numrin e punonjesve eshte Struktura e Re Organizative e miratuar ne Vitin 2009, e cila parashikon 131 personelt menaxhues ne raport me 450 punonjes operativ.

Nje Arsyje tjeter eshte rritja e pagave me Vendimin r Keshillit Drejtues me vleren 10% dhe rritjes se pages se grupit per efekt vjetersie nga Keshilli Ministrave nga 10.050 ne 12.000leke .

Paga mesatare mujore per nje punonjes, e planifikuar për vitin 2010 është parashikuar 73.284 lekë, ndersa ne vitin 2009 paga mesatare eshte realizuar per shumen 62.751 leke, duke parashikuar nje rritje te pages mesatare mujore per shumen 10.533 leke.

Fondi vjetor i pages i programuar për një punonjës për vitin 2010 është 879.408 lekë, ndersa ne vitin 2009 eshte realizuar per shumen 737.884 leke, 141.524 leke me shume ose 16%.

6. TREGUESIT E INVESTIMEVE TË BRENDSHME PËR VITIN 2010

Në Planin e Biznesit të vitit 2010 investimet janë parashikuar te kryhen investime me vlerë 1.757.048.657 lekë me fondet e veta te APD-së.

Per vitin 2010 janë parashikuar te kryhen investime me vlerë 3.186.700.000 leke. Brenda vitit 2010 me fondet e veta do te realizohen investime per shumen 1.757.048.657 leke, dhe blerjet e materialeve te ndryshme dhe sherbimet parashikohen per shumen 670.063.789 leke nga te cilat brenda vitit 2010 do te realizohen per shumen 491.748.125 leke.

Në këtë projekt plan per investimet, nuk janë parashikuar investimet me vlere të mëdha, si ndërtimi i Terminalit të ri të trageteve, ndërtimi i kalatave 7, 8, pasi siç dihet tashmë këto investime do të realizohen me financim me kredi nga BEI dhe BERZH-i . Per vitin 2009 jane parashikuar qe te prokurohen investime per shumen 3.075.072.417 leke, nga te cilat 2.275.072.417 leke do te

realizohen brenda vitit 2009, ndersa shuma prej 800.000.000 leke, qe perfaqeson rreth 50 % te vleres se Rikonstruksionit te Kalates Nr.10 do te realizohen per vitin 2010. Investimet në infrastrukture janë parashikuar në bazë të projekteve preventivave të hartuara për këtë qëllim, ndërsa investimet e tjera për makineri dhe pajisje, automekanizma dhe mjete teknologjike, dhe zërave përkatës janë parashikuar sipas çmimeve të tregut .

Investimet gjithsej per vitin 2009 qe do te financohen me fondet e APDse paraqiten sipas tabelës me poshte:

7. PARASHIKIMI I INVESTIMEVE 2010

Investimet sipas zerave, paraqiten si me poshte;

7.	OBJEKTET E INVESTIMEVE	SHENIME	VLERA /LEK	REALIZIMI NE 2010
1	NDERTIM MONTIME		1,492,371,483	1,000,415,427
2	BLERJE MAKINERI E PAJISIE		144,814,130	144,814,130
3	BLERJE MEKANIZMA		249,723,881	249,723,881
4	BLERJE AUTOMJETE		10,000,000	10,000,000
5	BLERJE PAJISIE INFORMATIKE DHE ORENDI PER ZYRA		160,430,290	160,430,290
6	PROJEKTE STUDIME DHE KONSULENCA		197,582,929	180,864,929
7	TE TJERA INVESTIME		10,800,000	10,800,000
		TOTALI PERGJITHSHEM	2,265,722,713	1,757,048,657

7.1 PARASHIKIMI I INVESTIMEVE PËR "NDËRTIM MONTIME"

Jane parashikuar te behen investime ne shumen **2,265,722,713 Lek**, nga te cilat **1,757,048,657 Lek** jane programuar te realizohen brenda vitit 2010.

Si dhe shihet nga tabela 7, investimet kryesisht jane te orientuara ne infrastrukture, ku jane parashikuar qe te realizohen prokurime per shumen **2.265.722.713 leke**, nga te cilat per vitin 2010 do te realizohen **1,757.048,657 leke**, pjesa tjeter prej 525,956,056 leke per shkak te afatit te zbatimit te disa projekteve mbetet te realizohen dhe te perfundojne ne vitin 2011. Sipas projekteve investimet per ndertim montime paraqiten si me poshte:

7.1.	NDERTIM MONTIME	SHENIME	VLERA /LEK	REALIZIMI NE 2010
1	Rikonstruksioni i godinave	Prokurim I 2009	100,350,000	60,000,000
2	Ndermi I sheshit pas prishje se magazines 7,9,10 dhe 11	Prokurim I 2009	22,500,000	22,500,000
3	Punim Sistemimi i dherave ne kalaten lindore	Prokurim I 2009	44,960,649	44,960,649
4	Ndertim I murit rrethues te ofcines dhe kinoklubit	Kontrate 2009	7,832,868	7,832,868
5	Rikonstruksioni i Kalates Lindore	Kontrate 2009	1,129,015,140	677,409,084
6	Punim sistemim sheshe hyrja nr 2	Kontrate 2009	772,880	772,880
7	Punim I godines se re dykateshe tek hyrja nr 2 dhe shtesa	Kontrate 2009	27,614,626	27,614,626
8	Checkini elektronik	Prokurim I 2009	115,230,000	115,230,000
9	Ngritja e dhomes se serverave backup vendodhja Magazina e kancelarive sot dhe ndertimi infrastruktures rrjetit		7,498,920	7,498,920
10	Prodhim elemente te parafabrikuar b/arme per ndarje zonash per depozitimin e rifuxhove		5,000,000	5,000,000
11	Rrethimi i Bregut Lindor me elemente te parafabrikuar b/arme + kangjell e zinguar		15,896,400	15,896,400
12	Punime metalike per mbylljen e ambienteve te Kapanonit te Parkut per krijim magazinash per njesite e mirembajtjes se Drejtorise Inxhinjerike, Rikonstruksioni i Ambienteve te ish-magazines ne godinen e Ofcines dhe kabinave elektrike		13,700,000	13,700,000
13	Ndarese per pershtatje ambiente pune te magazinave 4-5		2,000,000	2,000,000
		TOTALI NDERTIME	1,492,371,483	1,000,415,427

7.1.1 Rikonstruksioni I Nderteseve

Eshte parashikuar rikonstruksioni i ndertesave kryesore te administrates per nje shume rreth 100,350,000 leke, I aprovuar si ze edhe ne plan biznesin e vitit 2009 dhe I pa realizuar per shkak te anulimit nga APP,

Per shkak te permasave te punimeve sipas projektit, si dhe veshtiresive praktike te zbatimit ne praktik kete radhe eshte qe te realizohet ne dy pjese, ndaj per vitin 2010 propozojme te financojme zbatimin e rikonstruksionit te "Interklubit dhe sistemit te ngrohjes, per nje vlere rreth 60,000,000 leke, dhe

pjesa tjetër Rikonstruksioni i ndertesave kryesore (baze), janë parashikuar të kryhen pas perfundimit të fazës së parë, për diferencën prej 40,350,000 leke në vitin 2011.

7.1.2 *Ndertimi i Sheshit pas prishje së Magazines 7,9,10 dhe 11*

Është parashikuar prishja e magazinave 7,9,10,11, dhe kthimi i asaj hapësirë në shesh, e planifikuar kjo që në plan biznesin e vitit 2009, aktualisht janë kryer procedurat e prokurimit si dhe është lidhur kontrata për shumën rreth 50,500,000 leke dhe seshpejti fillon zbatimi i saj. Në këtë zë kemi listuar vetëm ndertimin e sheshit pas prishjes së magazinave, pasi ndertimi i tij klasifikohet Investim, ndërsa diferenca prej 28,00,000 leke gjendet në zërin Shpenzime.

7.1.3 *Punim Sistemimi i dherave në Kalatën Lindore*

Janë Parashikuar të kryhen punime për sistemimin e dherave në kalatën lindore për një vlerë prej 44,960,649 leke, e cila ka për qëllim njekohesisht krijimin dhe të hapsirave të reja në atë zonë, e programuar të kryhet në plan biznesin e vitit 2009, aktualisht janë kryer procedurat e prokurimit është lidhur kontrata dhe kanë filluar punimet.

7.1.4 *Ndertim i Murit Rrethues të Oficinës dhe Kinoklubit*

Është Parashikuar të kryhet ndertim i murit rrethues të oficinës dhe kinoklubit për një vlerë prej 7,832,868 leke, e cila ka për qëllim krijimin e kushteve me të mira për sigurinë në port, e programuar të kryhet në plan biznesin e vitit 2009, aktualisht janë kryer procedurat e prokurimit është lidhur kontrata dhe kanë filluar punimet.

7.1.5 *Ndertimi i Kalatës Lindore*

Ndertimi i kalatës lindore Nr.10 dhe 11, me vlerë të kuotuar në garë për rreth 1,129,015,140 leke me projekt të "TECHNITAL".

Aktualisht janë zhvilluar procedurat e prokurimit, është lidhur kontrata në dhjetor 2009 dhe sapo kanë filluar punimet.

Ka qenë një investim i miratuar në plan biznesin e vitit 2009, për të zgjeruar kapacitetet e perpunimit të ngarkesave rifuxho si të mineraleve etj.

Për shkak të afatit të perfundimit të punimeve është i parashikuar në kontratë 18 muaj, atëherë në projekt plan, është menduar të buxhetohet vetëm 60 % e vlerës së projektit, për një shumë rreth 677,409,084 leke për vitin 2010.

7.1.6 *Punim Sistemim Sheshë, Hyrja Nr 2*

Është programuar kryerja e punimeve në sheshin pranë hyrjes nr. 2, për një vlerë 772,880 leke, si një sistemim i asaj hapësirë pas perfundimit të ndertesës së re të zyrave.

Aktualisht janë kryer të gjitha procedurat e prokurimit si dhe është lidhur kontrata, në pritje të fillimit të punimeve.

7.1.7 *Punim i Godines se Re dykateshe tek Hyrja Nr 2 dhe Shtesa*

Projekti dhe preventivi për këtë godinë janë bërë sipas studimit të zonës qendrore të APD-së. Keto ambjente parashikohen të përdoren për, zyra administrate për operatorët në port.

Jane kryer procedurat e prokurimit, si dhe është lidhur kontrata dhe kanë filluar punimet që në 2009. Për shkak se një pjesë e punimeve është kryer në vitin 2009, parashikohet që në buxhetin e vitit 2010 të buxhetohet diferenca prej 27,614,626 leke

7.1.8 *Checkini Elektronik*

Ky është një projekt mjaft i rëndësishëm për të financuar, pasi realizimi i tij do të bëjë të mundur lehtësimin e procedurave të imbakimit në terminalin e Tragetëve e shoqëruar kjo me një efekt të lartë cilësor të informacionit të grumbulluar.

Implementimi i këtij projekti do të saktësojë jo vetëm informacionin e përpunimit të pasagjereve e mallrave në terminalin e pasagjereve, por mund të shtrihet dhe më tej, duke saktësuar njehkohesisht dhe të gjithë volumet e përpunimit të mallrave në çdo terminal tjetër., për në këtë mënyrë, mund të themi se APD, pas kësaj do të zotërojë të gjithë informacionin lidhur me volumet e operacioneve që kryhen në port, të gjeneruara nga sistemi i Saj dhe jo më nga raportimet e operatorëve të cilat në mënyrë të natyreshme janë të prirura të jenë të pakesuara, ndaj dhe përfitimi i APD në këtë rast do të jetë shumë planesh dhe i lartë.

Edhe ky, ka qenë një projekt i financuar në planin biznesin e vitit 2009, për të cilin aktualisht janë kryer procedurat e prokurimit dhe jemi në fazën e lidhjes së kontratës me kompaninë fituese për shumën 115,230,000 leke, e cila pritet që sipas afatëve të përfundojë në Brenda gjysmës së parë të vitit 2010.

7.1.9 *Ngritja e Dhomes se Serverave- Backup*

Sipas standarteve të krijimit dhe ruajtjes së informacionit, ka lindur e evojuar ndërtimi i një dhome Servera Backup, me qëllim mbrojtjen e informacionit në çdo rrethë.

Për këtë arsye në projektin planin biznesin e vitit 2010 kemi parashikuar të financojmë një shumë prej 7,498,920 leke, e cila përfshin si përshtatjen e dhomes me vendodhje ish magazinë e kancelarive, ashtu dhe pajisjet informatike dhe rrjetin e lidhjes me atë kryesor.

7.1.10 *Prodhim Elemente të Parafabrikuar B/Arme për Ndarje Zonash*

Me qëllim krijimin e kushteve për përmirësimin e menaxhimit të shesheve në kalatën lindore, si dhe organizimin më të mirë të saj, është parashikuar të prodhohen Elemente të parafabrikuar b/arme për ndarjen e hapësirave në

zonash per depozitimin e rifuxhove, Zbatimi I ketij projekti sipas preventivit dhe sasise qe kerkojme, shkon ne rreth 5,000,000 leke.

7.1.11 Rrethimi i Bregut Lindor me elemente te parafabrikuar B/Arme + Kangjell e Zinguar

Eshte parashikuar ne kete projekt plan, njekohesisht dhe financimi e tij ketij, investimi cili ka per qellim ritjen e elementeve te sigurise ne port, vlera e zbatimit te ketij projekti sipas preventivave eshte parashikuar te jete per rreth 15,896,400 leke.

7.1.12 Punime Ndertimi, Pershtatje

Ketu jane parashikuar nje grup punimesh si ; punime te lehta metalike per mbylljen e ambjenteve te kapanonit te parkut me qellim krijimin e disa ambienteve per tu perdorur nga drejtoria inxhinjrike por dhe per tu dhene me qera operatoreve ne port. Rikonstruksioni i ambjenteve te magazines ne ndertesen e ofcines e lene pa realizuar ne rikonstruksionin bere me pare, si dhe dhe punime per permiresimin e kabinave elektrike, te gjitha per nje shume prej 13,700,000 leke.

7.1.13 Ndarese per krijim Ambjente pune ne Magazinave 4-5

Per shkak te siperfaqes mjaft te madhe te kesaj magazine, e cila veshtireson dhenien me qera nje operatori te vetem, eshte parashikuar te investihet ne krijimin e strukturave portative ndarese te siperfaqes se saj ne kter njesi me te vogla, per te pasur mundesi dhenien e tyre me qera kater operatoreve njeheres, duk i garantuar ne kete menyre autonome e veprimtarise tyre ne te njejten magazine njeheresh, Vlera e zbatimit te ketij projekti sipas preventivit paraprak shkon rreth 2,000,000 leke.

7.2 PARASHIKIMI INVESTIMEVE PER MAKINERI DHE PAJISIE

Ne kete rubrike, eshte parashikuar te behen investime kryesisht ne instalime qe kae per qellim permiresimin e funksionimit dhe kontrollit te te operacioneve ne port,

7.2	BLERJE MAKINERI E PAJISIE	SHENIME	VLERA /LEK	REALIZIMI NE 2010
1	FV sistem ndricimi pas zones se depove te karburanteve	Prokurim I 2009	28,580,000	28,580,000
2	Blerje sistem stokimi per magazinat	Prokurim I 2009	27,000,000	27,000,000
3	Blerje FV radio (Kontrate 2009)	Kontrate e 2009	8,100,000	8,100,000
4	Sistemi i supervizimit te rrjetit elektrik	Prokurim I 2009	8,024,000	8,024,000

5	FV kondicionere per elektrovinca	Kontrate e 2009	928,900	928,900
6	Sherbimi I remontit te dy el/vincave 15Ton	Kontrate e 2009	38,200,000	38,200,000
7	FV instalim I sistemit te ndricimit te ofcines	Kontrate e 2009	1,461,230	1,461,230
8	Realizim i by-pass-it te linjes 20 kV nga rreth rrotullimi te ura "Dajlanit"deri te porta nr 4 APD.	Kontrate e 2009	3,200,000	3,200,000
9	Realizimi i sistemit te furnizimit me 54 priza per kontainere frigo.		9,000,000	9,000,000
10	Realizimi i mbrojtjes se linjes 20 kV nga n/stacioni shkozet		950,000	950,000
11	Blerje ambiente mobile te kompl. kushte pune		14,070,000	14,070,000
12	Blerje gjeneratore 30 dhe 150 KVA		5,300,000	5,300,000
		TOTALI MAKINERI	144,814,130	144,814,130

7.2.1 *Fv Sistem Ndricimi pas Zones se Depove te Karburanteve*

Eshte nje projekt i cili ka per qellim ndricimin e hapesires portuale mbrapadepove te karburantit, me synimin per te rritur sigurine aty, si dhe mundesine e perdorimit te saj ne cdo kohe. Vlere e projektit sipas preventivave parashikohet te jete perrreth 28,580,000 leke.

7.2.2 *Blerje Sistem Stokimi Per Magazinat*

Eshte parashikuar blerja e nje sistemi per stokimin dhe menaxhimin e stokut ne magazina, nje projekt mjaft i rendesishem si per kontrollin administrimin e vlerave materiale, ashtu dhe per menaxhimin e tyre.

Riorganizimi i magazines diktohet si nga implementimi i struktures se re organizative hyre ne fuqi ne 2009, ne te cilen veprimtaria ne port ndahet ne disa qendra perfitimi, por dhe ne implementimin e sistemit te menaxhimit te mirembajtjes MAINSAER, e cila ne kete rast do te perfshinte te gjitha llojet e mirembajtjeve ne APD, duke shperndare ne menyre te sakt shpenzimet e tyre sipas perfituesve, me efekte te drejtperdrejta ne saktesimin e shpenzimeve sipas qendrave si dhe percaktimin e kostove ne menyre tejet te sakte, ndaj dhe pare ne kete menyre konsiderohet mjaft i rendesishem financimi dhe realizimi i tij. Vlera e realizimit te ketij projekti shkon rreth 27,000,000 leke, dhe parashikohet te kryhet ne fillim viti 2010.

7.2.3 *Blerje Fv Radio*

Eshte parashikuar blerja e tyre per nje vlere prej 8,100,000 leke, me qellim permiresimin e komunikimit si te punonjesve operativ ashtu dhe atyre te forcave te sigurise.

7.2.4 *Sistemi i Mbikqyrjes dhe Kontrollit te Rrjetit Energjistik*

Eshte parashikuar gjithashtu financimi i projektit per Sistemin e mbikqyrjes dhe kontrollit te funksionimit te rrjetit energjistik, nisur nga veshtiresite qe krijon hapesira tejet e madhe e shtrirjes se tij, si dhe kerkesa per rritjen e efencences se nderhyrjeve dhe parandalimit te defekteve, Per kete qellim eshte parashikuar te financohet ky projektper Shumen 8.024.000 leke.

7.2.5 *Fv Kondicionere per Elektrovinca*

Blerje Kondicionere per vendosjen ne elektrovinca me qellim permiresimin e kushteve te punes me vlere 928,900 leke,

7.2.6 *Sherbimi i Remontit te pergjithshem te Dy El/Vincave 15ton*

Eshte parashikuar te kryhet Remonti i Pergjithshem i dy Elektrovincave 15 Ton, i programuar per tu kryer qe nga 2009, Aktualisht jane kryer procedurat lidhur kontrata per nje vlere prej 38,200,000 leke dhe kane filluar punimet te cilat parashikohen te mbyllen ne fundviti 2010.

7.2.7 *Fv Instalim i Sistemit te ndricimit te Oficines*

Eshte parashikuar te financohet projekti per shumen 1,461,732 leke per permiresimin e ndricimit ne hapesiren e ofcines, brenda saj dhe ne magazinën e re, me qellim kjo per te rritur mundesine e kryerjes se veprimtarise se mirembajtjes dhe ne turnet e nates. Aktualisht projekti eshte ne perfundim te zbatimit.

7.2.8 *Ndertimi By-Pass-It Te Linjes 20 Kv, nga Rreth Rrotullimi "Dajlanit", deri te Porta Nr4.*

Ka qene e detyrueshme devijimi i linjes egzistuese per shkak te problematikave ne sistemin e kullimitte ugrave te qytetit te Ura e Dajlanit, nepermjet se ciles kalonte dhe traseja e linjes se furnizimit 20kV, per kete arsye ne kushte emergjente u prokurua ky devijim financimi i se ciles mbetet per tu paguar per shumen 3,200,000 leke.

7.2.9 *Sistem i Furnizimit Me 54 Priza Per Kontainere Frigo.*

Eshte planifikuar te financohet ndertimi i nje sistemi furnizimi me energji elektrike te tesionit te ulet ne terminalin e Kontainereve per nje vlere prej 9,000,000 leke me qellim ushqimin e kontainereve Frigo gjate kohes se qendrimit te tyre ne terminal.

7.2.10 *Realizimi i Mbrojtjes Se Linjes 20 Kv Nga N/Stacioni Shkozet*

Eshte parashikuar financimi prej 950,000 leke, ndertimti ketij sistemit per mbrojtjen e instalimit te furnizimit 20kV te APD, nga N/Stacioni i Shkozetit, per te eliminuar demtimet e linjes si dhe rritur gatishmerine e funksionimit te saj.

7.2.11 *Blerje ambiente modulare te parafabrikuara, per banjo dhe cveshje ..*

Eshte parashikuar krijimi i kushteve ne terminale per cveshjen e punonjesve si dhe banjo per to, me nje vlere rreth 14,070,000 leke, ne te cilen nuk kompletimi me perfshihe raftet te cilat aktualisht gjinden ne magazine.

7.2.12 *Blerje gjeneratore 30 dhe 150 KVA.*

Jane parashikuar blerja e ketyre gjeneratoreve elektrik, per nje vlere prej 5,300,000 leke per garantimin e punes ne mungese te energjise nga rrjeti te disa ndertesave te administrates.

7.3 **Parashikimi i investimeve për blerje “Automekanizma”**

Për vitin 2010 janë parashikuar investime për blerje Automekanizma me vlerë **249,723,881 lekë** sipas emertimeve të pasqyruar në vijim:

7.3	BLERJE MEKANIZMA	SHENIME	VLERA /LEK	REALIZIMI NE 2010
1	Blerje Reachstacker	Prokurim I 2009	106,757,261	106,757,261

2	Koka terheqese	TRAKTOR	60,720,000	60,720,000
3	Shasi per konteinere 4 cope		19,320,000	19,320,000
4	Blerje grejfera, paisje ngarkuese per vinca portual	355 990 euro Kontrate 2009	49,126,620	49,126,620
5	Blerje spreder 20" - 40" per MHC		13,800,000	13,800,000
	TOTALI MEKANIZMA		249,723,881	249,723,881

7.3.1 *Blerje Reach Stacker*

Per shkat te rritjes se volumit te perpunimit te mallrave me Kontainere, por dhe per aresye se Reach Stacker-at aktual jane me mbi 24,000 ore pune secili, gje qe nuk garantojne gatishmeri teknike ne vijim te tyre, eshte programuar blerja e dy Reach Stackera te rinj, te planifikuara keto qe ne 2009, me nje vlere prej 106,757,261 leke.

7.3.2 *Blerje Koka Terheqese-Traktor.*

Jane planifikuar gjithashtu te blihen kater koka terheqese Traktor me nje vlere prej 60,720,000 leke, per perpunimin e Trailer -ve ne terminalin e Trageteve por dhe ne Terminalin e Kontainereve, kjo per shkak te rritjes se volumit te puneve ne to dhe perballimin e tyre.

7.3.3 *Blerje Shasi per perpunimin e Kontainereve.*

Jane planifikuar gjithashtu te blihen Shasi per perpunimin e Kontainereve me nje vlere prej 19,320,000 leke, per perpunimin Kontainereve ne Terminalin e Kontainereve, kjo per shkak te rritjes se volumit te puneve.

7.3.4 *Blerje Grejfera, Pajisje Ngarkuese per vinca portual.*

Eshte parashikuar pagesa prej 49,126,620 leke per blerjen e grejferave te porositur e kontraktuar ne 2009.

7.3.5 *Blerje Spreder 20" - 40" per Vincin Mobile MHC 200*

Eshte parashikuar blerja e nje Sprejderi per nje vlere 13,800,000 leke per vincin mobile MHC 200 qe operon ne Terminalin e Kontainereve, per shkak te vjeterimit te atij egzistues, dhe garantimit te operacioneve te ngarkimit per cdo rast.

7.4 **Parashikimi i investimeve për Blerje “AUTOMJETE”**

Për vitin 2010 është parashikuar blerja e nje automjeti Ambulance per emergjenca civile ne Port ne nje vlere prej 10,000,000 **lekë** sipas pasqyrës më poshtë:

7.4	BLERJE AUTOMJETE	SHENIME	VLERA /LEK	REALIZIMI NE 2010
1	Auto Ambulance komplet	EPIDEMIOLOGJI A	10,000,000	10,000,000
		TOTALI AUTO	10,000,000	10,000,000

7.5 Blerje Pajisje, Sisteme Informatike Dhe Orendi Per Zyra

Ne kete grup, eshte parashikuar te investohet si ne krijimin e sistemeve te reja informatike per menaxhimin, kemi parasysh ate per menaxhimin e puneveve terminalin e kontainereve, ashtu dhe per mirembajtjene e sistemeve egzistuese dhe permiresimin e tyre ne nje vlere te pergjithshme prej **160,430,290 lekë**. Te paraqitura sipas zerave le ti ndjekim ne vijim:

7.5	BLERJE PAJISIE INFORMATIKE DHE ORENDI PER ZYRA	SHENIME	VLERA /LEK	REALIZIMI NE 2010
1	Blerje pajisje informatike zyre dhe rinovim licenca per dy vjet Windows server, exchange, cisco, rinovim suporti per tre vjet per iron port (mbrojtje e-mail dhe kufizim faqe internet)	Prokurim v. 2009	35,000,000	35,000,000
2	Blerje kamera, bariera, kalune dhe lidhja me fiber optike per ISPS	Kontrate 2009	17,866,750	17,866,750
3	BACKUP I datave video per sistemin ISPS dhe per Rrjetin Informatik te APD		10,000,000	10,000,000
4	Pajsje dhe aksesore per sistemin e sigurise ISPS , dhe radionderlidhje		24,563,540	24,563,540
5	Container Terminal Operation Information System (software dhe aksesore)		65,000,000	65,000,000
6	Pajsje orendi per zyra		8,000,000	8,000,000
TOTALI PAJISJE ZYRE DHE INFORMATIKE			160,430,290	160,430,290

7.5.1 Blerje Pajisje Informatike Zyre dhe Licensa

Eshte parashikuar ne kete ze, Blerja e Pajisjeve per Zyra, si Kompjuterat printera dhe fotokopje jane permbledhur ne kete grup dhe shpenzimet lidhur me rinovimin e licensave si te sistemeve operative ashtu dhe ato Windows server per dy vjet. Gjithashtu dhe rinovimi i suportit per tre vjet per iron port (mbrojtje e-mail dhe kufizim faqe internet) eshte perfshire ne vleren e caktuar prej 35.000.000 leke.

7.5.2 Blerje kamera, bariera, kalune per sistemin e sigurise ISPS .

Jane parashikuar te blihen per nje vlere rreth 17,866,750 leke me qellim permiresimin dhe plotesimin e funksionimit te sistemit te sigurise ISPS.

7.5.3 Ndertimi i sistemit BACKUP I data Video

Eshte parashikuar ndertimi I sistemit Backup Data Video per sistemin ISPS por dhe per Rrjetin Informatik te APD per sigurine e rregjistrimit dhe ruajtjes se informacionit Video, vlere e ketij investimi sipas preventivit hartuar arrin ne rreth 10,000,000 leke.

7.5.4 Blerje Pajisje dhe aksesore per sistemin e sigurise ISPS.

Eshte parashikuar ne kete ze blerja e pajisjeve dhe aksesoreve, per nje shume 24,563,540 leke per mirembajtjen e funksionimit te sistemit te sigurise ISPS.

7.5.5 Container Terminal Operation Information System

Per shkat te rritjes se volumit te perpunimit te Kontainereve ku ne mbyllje te vitit 2009 u rregjistruan rreth 67,000 TEU, kerkohet instalimi i nje sistemi informatik per menaxhimin e operacioneve Container Terminal Operation Information System, te rekomanduar posacerisht per kete nivel te shvillimit sot e cila do te rise cilesie e menaxhimit me efekte te uljes se kostove dhe rritjes se performances. Sipas ofertave vlere e investimit planifikohet te jete rreth 64,000,000 leke, dhe parashikohet te realizohet per vitin ne vazhdim 2010.

7.5.6 Blerje Pajisje dhe orendi per zyra

Jane parashikuar te blihen disa set-e mobilie Zyre, per te mbuluar si ato te dala jashte perdorimit ato perpunonjesit e rinj, si dhe per permiresimin e kushteve te punes per nje pjese tjeter te tyre, vlere e planifikuar per blerjen e tyre do jete rreth 8,000,000 leke.

7.6 Parashikimi i investimeve për „Konsulenca, Studime dhe Projekte“

Për vitin 2010 janë parashikuar investime për konsulenca, studime dhe projekte, për shumën **180,864,929 lekë**, sipas zërave më poshtë:

7.6	PROJEKTE STUDIME DHE KONSULENCA	SHENIME	VLERA /LEK	REALIZIMI NE 2010
1	Hartimi i Projektit te thellimit (Prokurime 2009)		52,196,191	52,196,191
2	Hartim Projekt ide, Projekt zbatimi dhe Preventiv punimesh per Rikonstruksionin e Kalatave 1 dhe 2		50,000,000	50,000,000
3	Hartim Projekt ide, Projekt zbatimi dhe Preventiv punimesh per ndertimin e Skoljeres lindore ne Kalaten Lindore		11,000,000	11,000,000
4	Hartim Projekt ide, Projekt zbatimi dhe Preventiv punimesh per sistemimin e sheshit prane hyrjes nr.4 dhe ndertimin e Hyrjes nr 4 dhe rruges deri tek Terminali I trageteve		4,086,738	4,086,738
5	Hartim projekti per remontin e pergjithshem te elktrovincave 16-27 ton		2,000,000	2,000,000
6	Hartimi I projektit per kalimin e sherbimit te mirembajtjes se rret informatik, sistemi sigurise, checini elektronik, sistemi menaxhimit te treminalit te konteinereve, sistemi menaxhimit te mirembajtjes, sistemi I finances dhe te gjithe hardware dhe pajisje, operatorit privat		2,000,000	2,000,000
7	Hartimi I projektit per kalimin e sherbimit te mirembajtjes se aseteve te inxhinierise civile, operatorit privat		2,000,000	2,000,000
8	Hartimi I projektit per kalimin e sherbimit te mirembajtjes se instalimeve per furnizimin dhe shperndarjen e energjise elektrike, operatorit privat		2,000,000	2,000,000
9	Konsulence menaxhimi, Asistence permiresimi sistemit financiar, Plan Biznesit dhe Sistemit Statistikor.		33,436,000	16,718,000
10	Projekti Port risk 28000 euro		3,864,000	3,864,000
11	Supervizime dhe kolaudime per punime ndertimi		35,000,000	35,000,000
	TOTALI PROJEKTE STUDIME DHE KONSULENCA		197,582,929	180,864,929

7.6.1 Hartimi i Projektit te Thellimit

Eshte nje projekt mjaft i rendesishem per rritjen e shfrytezimit intensiv te kapaciteteve ne Port, Eshte parashikuar te financohet Hartimi i projektit per thellimin e basenit dhe Kanalit Hyres ne Port per nje vlere 52,196,191 leke, i miratuar ky dhe ne plan biznesin e vitit 2009, i pa realizuar per mungese konkurence.

7.6.2 Hartimi i Projekt zbatimit per Rikonstruksionin e Kalatave 1 dhe 2 .

Edhe ky nje projekt mjaft i rendesishem, Riberja e kalatave 1 dhe 2, kerkohen per faktin se jo vetem jane te vjetra e te amortizuara, por se jane te

projektuara per ngarkesa te vogla dhe per thellesi po ashtu, ndaj eshte parashikuar fillimisht per 2010 hartimi i projekteve ne nje vlere prej 50.000.000 leke

7.6.3 Hartim Projekt Zbatimi per ndertimin e Skoljeres lindore ne Kalaten Lindore

Eshte parashikuar hartimi I nje projekti per ndertimin e Sklieres ne kalaten lindore, per ti paraprire e kordinuar me projektin e thellimit, kjo ka per qellim krijimin e kushteve per depozitimin e materialit te nxjere nga thellimi, duke ulur koston nga elimnimi i transportit tyre ne det te hapur, po ashtu dhe nga perfitimi I trojeve te reja duke rritur hapesiren e siperfaqes se Portit.

7.6.4 Hartim Projekt zbatimi per sistemimin e sheshit dhe ndertimin e hyrjes nr.4

Eshte parashikuar hartimi I nje Projekt ide, Projekt zbatimi dhe Preventiv punimesh per sistemimin e sheshit prane hyrjes nr.4 dhe ndertimin e Hyrjes nr 4 dhe rruges deri tek Terminali I trageteve, kjo duhet bere per te lehtesuar trafikun ne kete porte kryesore, per te disiplinuar kontrollin dhe sigurine ne port, si dhe studjuar e organizuar instalimin e pajisjeve perkatese.

7.6.5 Hartim projekti per remontin e pergjithshem te elktrovincave 16-27 ton.

